



Misioni Ynë!

Fakulteti Juridik aspiron të jetë një komunitet akademik e studentor që gëzon një konkurrueshmëri të lartë në tregun akademik e mësimor, që ka qasje të lehtë, prani serioze dhe gëzon respekt të veçantë në tregun profesional të punës. Komunitet që kontribuon thelbësisht në shkencën juridike përmes literaturës origjinale dhe të botuar ndërkombëtarisht, e i cili bashkëpunon me shkollat elitë të fushës juridike, dhe që ka një shkëmbim të madh të personelit akademik e studentëve ndërkombëtar.

**Të inspiruar për të ardhmen,
me integritet dhe dije!**

Fakulteti Juridik (Universiteti i Prishtinës)



Universiteti i Prishtinës **FAKULTETI JURIDIK**

STUDIO JURIDIKUN DHE NIS RRUGËTIMIN TËND NË FUSHËN E DREJTËSISË!



Na kontaktoni:

Fakulteti Juridik (Universiteti i Prishtinës)

10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: 381(0)38 229 063/ 220 484

Email: juridiku@uni-pr.edu

Webfaqja: www.juridiku.uni-pr.edu

Informata të Përgjithshme

Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, është një prej fakulteteve më të mëdha dhe më të vjetra në vend.

Përveç traditës si institucion, tani Fakulteti Juridik i UP-së është edhe fakultet elitari në Kosovë, në fushën e drejtësisë.

Çka ofrojmë?

Fakulteti Juridik-UP ofron Programin 4 vjeçar të Studimeve Themelore (LL.B.).

Gjithashtu, dhe një vit të Studimeve Master (LL.M.) në 8 programe të ndryshme (përfshirë 2 programe në gjuhë angleze), sipas sistemit 4+1, si dhe studime të doktoratës (Ph.D.) me sistem 3 vjeçar.

Programi 4 vjeçar (LL.B) ofron mundësinë e formimit të duhur të juristëve të së ardhmes, bazuar në lëndë më përmbajtje të duhur teorike, zhvillimin e të menduarit kritik (argumentues) dhe shkathtësive praktike përmes mësimin klinik (Klinikave ligjore).

Kurrikula e reformuar konform standardeve më të mira ndërkombëtare, ofron përgatitjen e duhur të studentëve të diplomuar për nevojat e tregut të punës.

Personeli akademik i Fakultetit Juridik (UP) është i përbërë nga profesorë dhe asistentë me përgatitje superiore brenda dhe jashtë vendit, dhe përveç programit (kurrikulës) 4 vjeçar, fakulteti ofron edhe një gamë të gjerë të kurseve dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare.

Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës deri më sot ka nxjerrë kuadro të shumta, të cilat kanë dhënë një kontribut të pazëvendësueshëm në fushën e shkencës juridike, gjyqësisë, prokurorisë, administratës, politikës dhe në çështjet e shtet formimit e shtet ndërtimit të Kosovës.

Një numër shumë i madh i të diplomuarve tanë, kanë arritur të jenë pjesë edhe e tregut ndërkombëtar të punës, duke punuar për institucione dhe organizata ndërkombëtare,

kompani, firma ligjore, si dhe në universitete prestigjioze.

Fakulteti Juridik i UP-së ka marrëveshje bashkëpunimi me fakultetet juridike dhe universitet më prestigjioze në botë (sidomos ShBA, Britani e Madhe dhe Evropë), ku përfshihen mundësitë e projekteve dhe programeve të përbashkëta, mobilitetin e stafit dhe studentëve, si dhe forma tjera të bashkëpunimit.

Fakulteti Juridik ka edhe bashkëpunim me shumë institucione në Kosovë, në veçanti me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatën Supreme, Këshillin Prokurorial, Odën e Avokatëve të Kosovës, Akademinë e Drejtësisë, etj., ku kryesisht mundësohet praktika për studentë dhe realizimi i mësimin klinik.

Fakulteti Juridik gëzon edhe mbështetjen e partnerëve të shumtë për projektet dhe aktivitetet e tij, si: Ambasada Amerikane në Kosovë, Këshilli i Evropës, Zyra e BE-së, UNDP, UNHCR, si dhe ambasadat e Norvegjisë, Gjermanisë, Zvicrës, Italisë, etj.

Gjithashtu Fakulteti Juridik ka krijuar hapësira moderne dhe ambiente të përshtatshme për studentët.

Aktivitetet ekstrakurrikulare dhe mundësitë e shumta për studentët!

Si studentë të Fakultetit Juridik, përveç studimeve do të keni edhe shumë mundësi të tjera, si:

- angazhimi në shumë projekte hulumtuese për studentë me partnerë vendor dhe ndërkombëtar.
- të jeni pjesë në grupe të veçanta të studentëve të Fakultetit Juridik:
 - *Grupi i studentëve të ekselencës;*
 - *Klubi i Etikës;*
 - *Klubi i Debatit;*
 - *Grupi për garat dhe forumet ndërkombëtare, etj.*
- të përfitoni nga mundësitë e punës praktike në gjykata, prokurori, zyrë të avokatit, institucione publike, organizata vendore dhe ndërkombëtare, kompani, etj.

- angazhimi në kuadër të **Zyrës për Studime Klinike** (në kuadër të fakultetit) që nënkupton pjesëmarrjen në ofrimin e shërbimeve juridike për komunitetin në fusha/klinika të ndryshme, si penale, civile, e punës, të drejtat e njeriut, fiskale, etj.
- të jeni pjesë e programeve të certifikimit dhe kurseve të veçanta të specializimit.
- të jeni pjesë e ekipeve që përfaqësojnë Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës në garat ndërkombëtare me prestigjioze për studentët e drejtësisë, si:
 - **JESSUP (Washington/ShBA);**
 - **ICC Moot Court (Hagë/Mbretëria e Holandës);**
 - **VIS Moot (Vjenë/Austri);**
 - **etj.**
- të përfitoni nga mundësitë e shumta të shkëmbimit në kuadër të marrëveshjeve bilaterale me fakultetet më të mira në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe në kuadër të programeve Erasmus+ dhe Fulbright, etj.
- do të keni qasje në rrjetin e madh të **Alumni**, duke përfituar nga përvoja e të diplomuarve, përmes programeve të mentorimit, si dhe të bëheni pjesë e këtij komuniteti pas diplomimit, duke përfituar nga mundësi të shumta bashkëpunimi.

Për më shumë, shikoni edhe:

Webfaqja: www.juridiku.uni-pr.edu

Fcb: <https://www.facebook.com/FacultyofLawUP>

Video: <https://juridiku.uni-pr.edu/inc/video/video.mp4>

Programi i Zyrës së Dekanit 2020-2024:

<https://juridiku.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,59>